



---

**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh  
të Universitetit Politeknik të Tiranës  
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus +  
në University of A Coruña (UDC), Spanjë**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në University of A Coruña (UDC), Spanjë.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime.
- Shkëmbimin e stafit për mësimdhënie.

**Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi, në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës. Të kenë përfunduar një vit akademik, Bachelor.
- Shkëmbim stafi për mësimdhënie, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës.

**Kohëzgjatja e bursave:**

- Për studentët: 3 - 5 muaj, 1 semestër, autumn 2021
- Për pedagogë: 5 ditë

**Fusha e studimit:**

Arkitekturë

**Numri total i studentëve:** 3 studentë

**Numri total i pedagogëve për mësimdhënie:** 3 pedagogë

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve Bachelor, deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj\*;
- Dokumenti Learning Agreement\*\*.



Të gjithë aplikantët, duhet të pajisen me siguracion shëndetësor, të vlefshëm për Spanjën për tërë periudhën e qëndrimit.

\*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën, për studentët është B1. (Për stafin për mësimdhënie është B2.) Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.

\*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në University of A Coruña (UDC), Spanjë, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti "Learning Agreement" të seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore.

Për të shkarkuar formatin e "Learning Agreement" klikoni më poshtë:

[https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement\\_en](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement_en)

Për të parë listën e kurseve që ofron University of A Coruña (UDC), në anglisht, klikoni në linqet më poshtë:

<https://www.udc.es/en/ori/internacionalizacion/facultades/>

<https://estudios.udc.es/en/degrees>

Për më tepër informacion klikoni në linqet e mëposhtme respektive.

Students` mobility:

[https://www.udc.es/en/ori/infestudantesextranxeiros/mobilidade\\_Erasmus/erasmus-ka107/](https://www.udc.es/en/ori/infestudantesextranxeiros/mobilidade_Erasmus/erasmus-ka107/)

Staff - Teaching mobility:

[https://www.udc.es/en/ori/infPersonalEntrante/PersonalDocente/Erasmus\\_KA107/?language=es](https://www.udc.es/en/ori/infPersonalEntrante/PersonalDocente/Erasmus_KA107/?language=es)

Staff - Training mobility:

[https://www.udc.es/en/ori/infPersonalEntrante/PersonalAdministrativo/Erasmus\\_KA107/?language=en](https://www.udc.es/en/ori/infPersonalEntrante/PersonalAdministrativo/Erasmus_KA107/?language=en)

### **Afati për aplikim: deri më 14 Maj 2021**

Aplikimi kryhet pranë Sektorit të Koordinimit dhe Partneritetit, në Drejtorinë e Komunikimit dhe Koordinimit.

Për informacione shtesë, në lidhje me procesin e aplikimit, mund të kontaktoni në email: [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al)